



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Akuzat se ndau çiftin Luiz-Klara përgjigjet Zhaklin Lekatan



Me ndihmoni të gjej djalin/ Nëna shqiptare në Greqi apel për ndihmë: Pas një muaji ai do të kishte ditëlindjen



I burgosur në burgun e Turqisë, babai kërkon leje për të shkuar në varrimin e djalit që i vdiq pas përplasjes së trenave në Greqi



Po e riparonia, kamioni ze poshtë shoferin në Sarandë! Ndërron jetë 53-vjeçari (VIDEO)



Eva Alikoji flet për herë të parë pas përjashtimit nga "BBV": U kërkoj falje shqiptarëve

Kronikë

Mat/ Pesë adoleshentë konfliktohen me njëri-tjetrin, 17-vjeçarit iu gjet kallashnikov me 800 fishekë

Pesë adoleshentë në Mat, Dibër janë konfliktuar me njëri-tjetrin dhe njëri prej tyre kishte të fshehur dy armë zjarri kallashnikov me 800 fishekë.



Foto nga arma që iu gjet 17-vjeçarit




Redaksia

2 Mars, 14:02 | Përditësimi: 2 Mars, 14:10



Pesë adoleshentë në Mat, Dibër janë konfliktuar me njëri-tjetrin dhe njëri prej tyre kishte të fshehur dy armë zjarri kallashnikov me 800 fishekë. Sipas informacioneve, ngjarja ka ndodhur në lagjen "Pjetër Budi" rreth orës 17:00. Policia arriti në kohë në vendngjarje dhe arriti të parandalojë përshkallëzimin e situatës. Sipas policisë, të pestë adoleshentët po procedohen në gjendje të lirë. Falë ndërhyrjes së menjëhershme dhe profesionale të shërbimeve të Policisë, është bërë e mundur kapja dhe shoqërimi në Komisariat i shtetasve M.L., 15 vjeç; A.D., 16 vjeç; L.H., 16 vjeç; K.C., 17 vjeç; R.Z., 17 vjeç, të gjithë banues në Burrel.

Pas konfliktit mes njëri tjetrit për motive të dobëta, janë konfliktuar me grushte dhe si pasojë kanë mbetur të lënduar lehtë R.Z dhe A.D. Policia i ka gjetur R.Z., dy armë zjarri kallashnikov dhe 800 fishek që i kishte fshehur në një vend me barishte, të cilat dyshohej se mund ti përdorte në këtë konflikt. Armët e zjarrit dhe sasia e municionit janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe vijnë hetimet për zbardhjen se si 17-vjeçari ka siguruar armët e zjarrit.



LEXO EDHE:
Qarkullonte me armë zjarri pa leje, në pranga 19-vjeçari në Shkodër (VIDEO)

Mbi të pestë adoleshentët rëndojnë akuzat "Dëmtime të tjera me dashje", "Plagosje e lehtë me dashje", dhe ndaj shtetasit R.Z., për veprat penale "Dëmtime të tjera me dashje", dhe "Armëmbajtje pa leje".

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë për veprime të mëtejshme.

F.D/Shqiptarja.com

TAG: mat, Dibër, policia e Dibres, plagosje me dashje, armëmbajtje pa leje

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:
Apeli rrëzon Berishën e vula e PD i mbetet Alibeajt, si e vlerësoni?

Të drejtë Të gabuar Nuk e di

Lajme të tjera



Mashtroi se i kishin vjedhur materiale në ambientin ku punonte, vihet në pranga 62-vjeçari në Bulqizë

28 Shkurt, 17:45



Me pistoletë dhe dy çekicë në makinë, arrestohen tre persona në Tiranë, njëri prej tyre kërcënoi oficerët e policisë (EMRAT)

26 Shkurt, 13:04



Lëviznin me armë në makinë, arrestohet 19-vjeçari në Durrës, në kërkim shoku i tij! Rrezikuan jetën e efektivëve pasi tentuan të arratisen

25 Shkurt, 10:30



Policia e Shtetit hap aplikimet për 300 vende pune: Ja kriteret që duhet të përmbushni

24 Shkurt, 13:32



Shmanget tragjedia në Klos/ Thyhen dërrasat e urës, ngec furgoni me pasagjerë (VIDEO)

23 Shkurt, 18:11



E rëndë në Klos, 57-vjeçari nuk ndihej mirë para se të merrte punën! Ndërroi jetë në spital

22 Shkurt, 10:46



Ndezi zjarr në vendin e quajtur 'Kepi i djepzave', në pranga 38-vjeçari në Klos

21 Shkurt, 09:12



U futën në shpellën e malit të Klenjës për të rregulluar tubacionin, asfiksohen dy persona! Dërgohen në spital

19 Shkurt, 20:41




Katër persona në Klos nuk i binden urdhrat të policisë për të ndaluar! Braktisin mjetin dhe largohen, gjenden maska dhe fishekë në makinë

19 Shkurt, 15:10



VIDEO/ Përfshihen nga flakët 5 ha pyje dhe kullota në Plan i Bardhë në Klos! Forcat zjarrfikëse ndërhyjnë për të shuar zjarrin

19 Shkurt, 14:17



Lëvizte me armë zjarri në makinë, arrestohet 42-vjeçari në Tiranë (VIDEO)

18 Shkurt, 13:38



Ishte në kërkim për kultivim kanabisi në Mat, në pranga 21-vjeçari! I sekuestrohen 187 rrënjë

16 Shkurt, 14:18